VENDIM
Nr.1, datë 13.7.1992

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërise, e përbërë nga:

Rustem Gjata	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani	Zv/kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Thimjo Kondi	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Natasha Sheshi	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Ylvi Myrtja	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Franc Jakova	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Në mungesë të anëtarëve, Manol Konomi e Hilmi Dakli, për arsye shëndetësore me sekretar Ylli Mahmuda, më datën 13.7.1992, shqyrtoi në seancë gjygjësore me dyer të hapura çështjen nr. 2 që i përket:

KËRKUES: Komiteti Organizator Qëndror i Partisë Komuniste Shqiptare

OBJEKTI I KËRKESËS

Të deklarohet pakushtetushmëria dhe paligjshmëria e vendimit nr.199, datë 20.5.1992, të Kryesisë së Këshillit të Ministrave "Për kalimin në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit të fondeve arkivore të PPSh, BGSh, BRPSh, BPSh, e FDSh"..

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi relatimin e çështjes

VËREN:

Me Vendimin e Kryesisë së Këshillit të Ministrave nr.199, datë 20.5.1992 "Për kalimin në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit të fondeve arkivore të PPSh, BGSh, BRPSh, BPSh e FDSh", është vendosur që fondet arkivore të ish-PPSh, si dhe të ish-organizatave politike të ashtuquajtura "leva" të saj, që konsiderohen fonde me cikël veprimtarie të mbyllur, të bllokohen dhe të fillojë menjëherë dorëzimi i tyre në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit për administrim të përhershëm. Për këtë qëllim Kryesia e Këshillit të Ministrave ka parashikuar edhe fonde të posaçme, ka përcaktuar afatin e dorëzimit (brenda 3/mujorit të parë të vitit 1993), si dhe masat e tjera organizative të nevojshme.

Me kërkesën datë 27.5.1992, regjistruar në protokollin e kësaj gjykate më datë 2.6.1992, Komiteti Organizator Qendror i PKSh, kërkon shfuqizimin e vendimit të lartpërmendur të Kryesisë së Këshillit të Ministrave, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me ligjin për arkivat.

Komiteti Qendror Organizator i PKSh, pretendon se Vendimi i Këshillit të Ministrave shkel të drejtën e pronësisë e të autorësisë së kësaj partie, si vazhduese e PPSh, mbi dokumentet me vlera kombëtare, të prodhuara prej saj ose të lënë në ruajtje nga persona të ndryshëm, si dhe i hap rrugën keqpërdorimit, dëmtimit e falsifikimit të tyre në interes të partive në pushtet.

Nga dokumentet e dosjes së PKSh të depozituara në arkivin e Ministrisë së Drejtësisë rezulton se Partia Komuniste Shqiptare e miratuar me urdhërin nr.43/1, datë 9.11.1991, të Ministrit të Drejtësisë, në kërkesën për miratim e ka prezantuar veten si bashkim vullnetar i shtetasve me ideale komuniste, ish-anëtarë ose jo të ish-PPSh, përfaqësuesit e të cilëve, të zgjedhur si Komitet Organizator, vendosën krijimin e saj më 10.9.1991.

Sipas projektprogramit të saj, PKSh paraqitet si forcë politike e re e krijuar në një situatë të re pluraliste, si alternativë e re në jetën politike të vendit.

Lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese çmon se, pavarësisht nga fakti nëse Partia Komuniste Shqiptare do të rezultonte vazhduese e drejtpërdrejtë dhe trashëgimtare e të drejtave

dhe detyrimeve të ish-PPSh, (të emërtuar më parë Partia Komuniste Shqiptare), apo do të konsiderohej parti e re, siç ka pretenduar në kohën e miratimit të saj, problem që del jashtë kuadrit të këtij gjykimi, kjo parti nuk legjitimohet në pretendimet e saj për t'iu dorëzuar arkivi i ish-PPSh. Gjithashtu, nuk legjitimohet për një të drejtë të tillë, as Partia Socialiste e Shqipërisë, as edhe ndonjë parti tjetëraktualisht e krijuar apo riorganizuar, ose që mund të krijohet a riorganizohet eventualisht.

Në arritjen e këtij përfundimi, Gjykata Kushtetuese ka parasysh pozitën e veçantë determinuese dhe komanduese që zinte në jetën politike, ideologjike, ekonomike e sociale të vendit tonë Partia e Punës e Shqipërise,gjatë sundimit të saj diktatorial për afër gjysëm shekulli. Këtë karakter dhe pozitë të veçantë si parti-shtet, ose si shtet mbi shtetin, kjo parti ia ka imponuar shoqërisë shqiptare edhe me forcën e kushtetutave të hartuara e të miratuara prej saj. Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, e miratuar nga Asambleja Kushtetuese më 14.3.1946, me ndryshimet e vitit 1950 (G.Z. Nr.19/1946 dhe G.Z. nr.50/1950), në nenin 21 të saj, ndër të tjera, shpallte se Partia e Punës së Shqipërisë është "...bërthama udhëheqëse e të gjitha organizatave të punonjësve, si shoqërore ashtu edhe shtetërore", ndërsa Kushtetuta e RPSSh, miratuar me ligjin nr.5506, datë 28.12.1976, ndryshuar me ligjin nr.6799, datë 29.6.1983, në nenin 3, paragrafi i parë, shpallte se: "PPSh, pararoja e klasës punëtore, është forca e vetme politike, udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë". Për më tepër, vendimet e Kongreseve të Partisë, të Byrosë Politike, të Komitetit të saj Qendror, deri edhe ato të organeve më të ulta të saj, të ashtëquajturat direktiva të Partisë, ndonëse nuk cilësoheshin në mënyrë të shprehur si burime të së drejtës, qëndronin mbi Kushtetutën dhe ligjet, përbënin bazën e të gjithë veprimtarisë shtetërore e shoqërore në të gjitha fushat, kushtëzonin gjithë procesin e hartimit, miratimit, zbatimit dhe interpretimit të normave juridike. Për rrjedhojë, veprimtaria e organit më të lartë ligjvënës, Kuvendit Popullor, e Presidiumit të tij dhe e organeve të tjera shtetërore, kthehej në një veprimtari konfirmuese formale. Për më tepër, fusha të gjera e të rëndësishme të veprimtarisë shtetërore, në mënyrë të veçantë veprimtaria e sektorëve të rëndësishëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Jashtme, të Mbrojtjes e të organeve të drejtësisë, rregulloheshin vetëm ose kryesisht me akte partiake dhe vartësia e tyre shtetërore ishte fiktive. Veprimtaria e tyre praktikisht nuk organizohej, drejtohej e kontrollohej në rrugë shtetërore. Në këto kushte, një numër i konsiderueshëm vendimesh, direktivash e aktesh të tjera, të miratuara nga organet partiake, por që rregullonin veprimtarinë shtetërore, nuk komunikoheshin fare në rrugë shtetërore.

Këto dokumente të shumta që pasqyrojnë veprimtarinë shtetërore të partisë-shtet, përbëjnë materiale me vlera të përgjithshme për fondin arkivor të shtetit dhe duhet t'i kalojnë Drejtorisë së së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, në zbatim të neneve 1, 2 të ligjit nr.6893, datë 19.6.1984 "Për fondin arkivor të shtetit dhe për arkivat".

Veprimtaria e Partisë së Punës së Shqipërisë si parti-shtet vazhdoi deri sa u arrit fitorja e Revolucionit Demokratik, e cila u sanksionua me miratimin e ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", në të cilin parashikohet se: "Republika e Shqipërisë është shtet juridik dhe demokratik", (neni 2, Paragrafi i parë), se "Pluralizmi politik është një nga kushtet themelore të demokracisë në shtetin shqiptar.

Partitë politike dhe organizatat e tjera, krijohen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin. Ato janë krejtësisht të ndara nga shteti".

Në kuptim të dispozitave kushtetuese të mësipërme, arkivi i ish-partisë-shtet, është pasuri kombëtare dhe si e tillë duhet t'i kalojë shtetit.

Gjykata Kushtetuese gjithashtu i gjen të pabazuara pretendimet e tjera të PKSh. Kalimi i arkivit të ish-PPSh në fondin arkivor të shtetit, në bazë të Vendimit të Kryesisë së Këshillit të Ministrave, nuk është veprim anti-demokratik i partive politike në pushtet dhe akt-sekuestrimi, por është vetëm administrim i një pasurie kombëtare. Në këtë mënyrë krijohen kushte dhe garanci që të mbrohen më mirë edhe interesat e shtetasve, që mund të kenë depozituar dokumenta personale në arkivin e Partisë së Punës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 24, pika 3 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4. 1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", duke e gjetur kushtetues dhe të ligjshëm vendimin nr.199, datë 20.5.1992 të

Kryesisë së Këshillit të Ministrave,

VENDOSI:

Të rrëzojë si të pabazuar kërkesën e Komitetit Organizator Qëndror të Partisë Komuniste Shqiptare.

Vendimi është i formës së prerë

Tiranë, më 13.7.1992